



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2022

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Gjuhë shqipe dhe letërsi (Gjimnazi dhe gjimnazi gjuhësor)

Varianti A

Shënim: Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet e hapura, që kanë më shumë se një mundësi përgjigjeje dhe ku nxënësit shprehen shpesh, edhe me përgjigje të përafërta.

PJESA I

Helena Kadare “Kohë e pamjaftueshme”

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë
Pyetja 7	B	1 pikë
Pyetja 8	D	1 pikë
Pyetja 9	C	1 pikë

Pyetja 10 **2 pikë**

Përgjigje:

- mrekulli OSE mrekullitë
- shkaqe OSE shkaqet

2 pikë Nëse nxënësi gjen shumësin e të dy emrave.

1 pikë Nëse nxënësi gjen shumësin e një prej emrave **OSE** nëse nxënësi gjen dy variante shumësi të të njëjtit emër.

0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet fare ose jep përgjigje të gabuar.

Pyetja 11 **2 pikë**

Model përgjigjeje:

- **Unë**, e dhënë pas dashurisë **së madhe**, kisha qenë e pavëmendshme ndaj asaj që po ndodhte përreth.
- Etj.

2 pikë Nëse nxënësi zgjeron fjalinë me një kryefjalë dhe me një përcaktor.

1 pikë Nëse nxënësi zgjeron fjalinë me kryefjalë ose përcaktor.

0 pikë Nëse nxënësi nuk e zhvillon pyetjen ose e zgjeron atë në mënyrë të gabuar.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të pranojë si përgjigje të saktë çdo kryefjalë dhe përcaktor të vënë nga nxënësi, që shkon me kuptimin e fjalisë.

Pyetja 12 **4 pikë**

Model përgjigjeje:

Karakteristikat:

- Përdorimi i vetës së parë dhe të tretë.
- Gjuha e përdorur është e ngjashme me ligjërimin bisedor, e thjeshtë, e qartë dhe e prekshme. Hollësitë janë të lidhura me temën kryesore (jetën e shkrimtarit Ismail Kadare).
- Shpesh ka përshkrime të gjalla me figura si: metafora, epiteti metaforik, krahasimi etj.
- Ka përdorim të datave, që kanë lidhje me ngjarjet, ka referime kohore dhe vendore, emra personazhesh realë.
- Përdorimi i foljeve në kohët e të shkuarës. Denduri foljesh që tregojnë veprime, ndjenja, ngjarje etj.
- Përdorim i foljeve në formën joveprore.
- Përdorim i fjalive të shkurtra (për situata dramatike) dhe fjalive të gjata (për hollësi e përshkrime).

4 pikë Nëse nxënësi jep dy nga karakteristikat me shembujt përkatës.

3 pikë Nëse nxënësi jep dy karakteristikat dhe vetëm një shembull.

2 pikë Nëse jep një karakteristikë me shembullin përkatës, ose nëse jep vetëm dy karakteristikat.

1 pikë Nëse jep vetëm një karakteristikë.

0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet fare ose jep përgjigje të gabuar

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përgjigje të nxënësit, që nuk është si formulimet më lart, por që në një mënyrë tjetër, të çon në veçori gjuhësore të tekstit.

Pyetja 13 **4 pikë**

Përgjigje:

Helena Kadare përshkruan gëzimin e **daljes** së librit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, i cili konsiderohet si një nga librat më të **mirë** të kohës.

- | | |
|---------------|--|
| 4 pikë | Nëse nxënësi korrigjon katër nga gabimet në fjali. |
| 3 pikë | Nëse nxënësi korrigjon tri nga gabimet në fjali. |
| 2 pikë | Nëse nxënësi korrigjon dy nga gabimet në fjali. |
| 1 pikë | Nëse nxënësi korrigjon një nga gabimet në fjali. |
| 0 pikë | Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare. |
-

PJESA II

Viktor Hygo “Katedralja e Parisit”

- | | | |
|------------------|----------|---------------|
| Pyetja 14 | C | 1 pikë |
| Pyetja 15 | C | 1 pikë |
| Pyetja 16 | A | 1 pikë |
| Pyetja 17 | B | 1 pikë |
| Pyetja 18 | B | 1 pikë |
| Pyetja 19 | C | 1 pikë |
| Pyetja 20 | B | 1 pikë |
| Pyetja 21 | A | 1 pikë |
| Pyetja 22 | D | 1 pikë |
| Pyetja 23 | D | 1 pikë |
| Pyetja 24 | A | 1 pikë |

Pyetja 25 **1 pikë**

Model përgjigjeje:

Togfjalëshi *demon mbrojtës* shpreh raportin midis **Kuazimodos dhe katedrales**. Ky raport shpreh tiparin romantik të veprës, që është i lidhur me elementet fantastike, magjike, etike dhe estetike; kontrastin midis pamjes së jashtme dhe botës së brendshme shpirtërore.

1 pikë Nëse nxënësi jep përmes shpjegimit të tij raportin/kontrastin.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje që nuk ka lidhje me kontekstin, ose nuk përgjigjet fare.

Shënim Komisioni do të vlerësojë me pikë çdo përgjigje të nxënësit, që edhe në mënyrë të përafërt është brenda kontekstit të përgjigjes në skemë.

Pyetja 26 **1 pikë**

Model përgjigjeje:

Shprehja kërkon të japë qasjen e kujdesit që tregon Kuazimodo për Esmeraldën. Për këtë shfrytëzohet paralelizmi figurativ.

1 pikë Nëse nxënësi jep paralelizmin, ose krahasimin, ose ngjashmërinë e shprehjes me kujdesin që tregon Kuazimodo për Esmeraldën.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk përgjigjet fare.

Shënim Komisioni do të vlerësojë me pikë çdo përgjigje të nxënësit, që edhe në mënyrë të përafërt është brenda kontekstit të përgjigjes në skemë.

Pyetja 27 **2 pikë**

- Nxënësi duhet të përshkruajë raportin midis tyre me elemente joreale, madhështore dhe të ndërvarur nga njëri-tjetri.
- Shembuj: mbiemra në shkallën sipërore, ose mbiemra të përbërë, ose fjalia ku tregohet varësia nga njëri-tjetri.

Model përgjigjeje:

Ndërtesë madhështore (Katedralja) dhe Qenie e jashtëzakonshme (Kuazimodo) **OSE** Jetëdhënës, **OSE** Katedralja dukej sikur i nënshtrohej pushtetit të tij.

2 pikë Nëse nxënësi shpjegon raportin dhe gjen shembull për këtë raport.

1 pikë Nëse nxënësi gjen vetëm shembullin, ose jep vetëm raportin.

0 pikë Nëse nxënësi gjen shprehje të gabuara dhe raport të gabuar, ose nuk përgjigjet fare

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë me pikë, një ose disa shembuj, që e tregojnë raportin Kuazimodo-katedrale në pjesën e parë dhe çdo përshkrim raporti të përcaktuar nga nxënësi dhe që del në këtë pjesë.

Pyetja 28 **2 pikë**

Model përgjigjeje:

Krahasimi:

Si koka e një luani, OSE si ndonjë copë pëlhurë e bardhë, OSE si të ishte plaçka e tij.

Funksioni: Roli i figurës lidhet me portretizimin e Kuazimodos, si karakteristikë romantike.

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen një nga krahasimet dhe shpjegon funksionin e tij
1 pikë Nëse nxënësi gjen vetëm krahasimin, por nuk e shpjegon atë.
0 pikë Nëse nuk përgjigjet fare ose gjen përgjigje të gabuara.
-

Pyetja 29 **2 pikë**

Përgjigje:

Figura letrare: Hiperbolë.

Shpjegimi: Hiperbola përdoret në funksion të dhënies së detajeve portretizuese të Kuazimodos.

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen hiperbolën dhe shpjegon efektin e saj.
1 pikë Nëse nxënësi gjen vetëm hiperbolën.
0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet ose jep përgjigje të gabuar.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë me pikë, një ose disa shembuj, që e tregojnë raportin Kuazimodo-katedrale në pjesën e parë dhe çdo përshkrim raporti të përcaktuar nga nxënësi dhe që del në këtë pjesë.

Pyetja 30 **1 pikë**

Nxënësi përshkruan momentet romantike në fund të fragmentit, që lidhen me përjetimin e lehtësimit dhe të qetësisë së Esmeraldës.

- 1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon me një përgjigje, që përngjason me skemën ku të dalë ndjeshmëria, ose qetësia, ose lehtësimi i Esmeraldës.
0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet ose jep përgjigje të gabuar.
-

Pyetja 31 a **1 pikë**

Përgjigje:

Atëherë gratë qeshnin e qanin, turma brohoriste nga entuziazmi.

- 1 pikë** Nëse gjen fjalët që realizojnë përshkallëzimin e reagimit të turmës.
0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet ose jep përgjigje të gabuar.
-

Pyetja 31 b **1 pikë**

Përgjigje:

Qeshnin e qanin

1 pikë Nëse nxënësi gjen antitezën.

0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet ose jep përgjigje të gabuar.

Pyetja 31 c **1 pikë**

Përgjigje:

Antonim / Folje

1 pikë Nëse nxënësi gjen antonimin ose foljen.

0 pikë Nëse nuk përgjigjet fare ose për përgjigje krejt të gabuara.

Pyetja 32 **4 pikë**

Model përgjigjeje

- Shembulli i përshkrimit fantastik të çon te fragmenti i dytë, sidomos tri fjalitë e fundit. Përfytyrimi që ngjall veçanërisht syri i ciklopit.
- Komenti është i lidhur me frymën romantike dhe gërshetimin e realizmit me romantizmin.
- Shembulli i lakonizmit na çon te dialogu midis Esmeraldës dhe Kuazimodos.
- Komenti lidhet me përdorimin e fjalive të shkurtra në një stil lakonik, që tregojnë gjendjen emocionale të Esmeraldës dhe Kuazimodos, frikën, kujdesin e tij, që të mos e trembë, dashurinë e tij deri në vetëflim dhe trishtimin e tij për pamjen etj.

4 pikë Nëse nxënësi jep dy shembuj dhe dy komentet përkatëse.

3 pikë Nëse nxënësi jep dy shembujt dhe jep njërin prej komenteve.

2 pikë Nëse nxënësi jep dy shembuj **OSE** një shembull dhe një koment.

1 pikë Nëse nxënësi jep vetëm një shembull.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë me pikë, një ose disa shembuj, që e tregojnë raportin Kuazimodo-katedrale në pjesën e parë dhe çdo përshkrim raporti të përcaktuar nga nxënësi dhe që del në këtë pjesë.

Pyetja 33 **2 pikë**

Model përgjigjeje

- Afria me prozën poetike është e lidhur me gjetjen në fragment të përshkrimeve, detajeve, figurave, sidomos epiteteve, fjalëve me ngjyrim emocional etj. Mund të përmendet edhe muzikaliteti që krijohet përmes përsëritjes së bashkëtingëlloreve "s" dhe "sh".

DHE

- Shembujt mund të merren nga përshkrimi i katedrales, Kuazimodos, nga lidhja e varësisë midis katedrales që i bindej Kuazimodos, si dhe nga fjalë e shprehje tingullore e me efekte.

2 pikë Nëse nxënësi shpjegon afrinë me prozën poetike dhe jep një shembull.

1 pikë Nëse nxënësi shpjegon afrinë, por nuk jep shembull ose jep një shembull, por nuk shpjegon asgjë.

0 pikë Nëse jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 34 a **1 pikë**

Përgjigje:

Gjymtyrët homogjene: butësi, ëmbëlsi, dhembshuri

1 pikë Nëse nxënësi jep gjymtyrët homogjene.

0 pikë Nëse nuk përgjigjet fare ose jep përgjigje të gabuar.

Pyetja 34 b **1 pikë**

Model përgjigjeje:

Butësia, ëmbëlsia dhe dhembshuria e Kuazimodos.....do të jenë kryefjalë të një fjalie të formuar nga nxënësi.

1 pikë Nëse nxënësi formon saktë vetëm fjalinë me gjymtyrët homogjene në rolin e kryefjalës.

0 pikë Nëse nuk përgjigjet fare ose jep përgjigje të gabuar.

PJESA III

Pyetja 35 8 pikë

Për pjesën *ese* do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

Shtjellimi i idesë 2 pikë

- shkruan një *ese*, ku argumenton ndikimin e kategorisë së të bukurës te njeriu.
- zbërthen argumentet e dhëna përmes detajesh të shumëllojshme shpjeguese dhe përshkrimi mbështet shpjegimin përgjatë gjithë shtjellimit;
- sjell përvoja të ndryshme personale, të cilat mbështetin bindshëm argumentin, jep shembuj dhe krijon përfytyrime

Organizimi dhe struktura 2 pikë

- përdor strukturë të qartë *eseje*: hyrje-zhvillim-mbyllje.
- siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

Stili dhe origjinaliteti 2 pikë

- përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

Saktësia gjuhësore 2 pikë

- përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e *esesë*;
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj., gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.

Shënim: Në vlerësimin e *esesë*, rubrikat që do të vlerësohen nuk mund të shihen të palidhura me njëra-tjetrën, pasi ato nuk mund të kenë një mëvetësi të plotë, ato shihen në harmoni. Nga ana tjetër, ky komision do të ketë parasysht, që për rubrikën stili (ku deri më sot janë treguar më të rezervuar) të mbahet në konsideratë që shkruesi i *esesë* është një nxënës dhe jo një shkrimtar.

Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përpjekje të nxënësit.